



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI AUDITIMIT PËR KOMUNËN E VUSHTRRIË
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyres Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës së Vushtrrisë, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Ajtene Llapashtica* udhëheqës ekipi; *Lindita Ajeti* dhe *Fisnik Rudaj* anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Faruk Rrahmani*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	27
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	29
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	37
Shtojca II: Letër Konfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i komunës së Vushtrrisë për vitin 2018, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 30/10/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës. Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Komunës së Vushtrrisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i Çështjes

Si theksim të çështjes, ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për subvencione dhe mallra e shërbime prej 181,310€ ishin keqklasifikuar pasi që ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoritë jo adekuate. Po ashtu, informatat e shpalosura në Pasqyra Financiare për llogaritë e arkëtueshme nuk ishin të plota pasi që ishin nënvlerësuar për 309,175€.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:



Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Shpenzimet për Subvencione dhe Transfere në vlerë prej 98,068€¹ ishin buxhetuar gabimisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe investimeve kapitale;
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vlerë prej 83,242€² ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Komuna nuk kishte bërë shpалosjen e llogarive të arkëtueshme për “Shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave” në vlerë prej 309,175€ duke nënvlerësuar të arkëtueshmet.

Planifikimi jo i mirë i buxhetit nëpër kategori ekonomike ka ndikuar që edhe shpenzimi të jetë i keqklasifikuar, kurse te llogaritë e arkëtueshme ishte fakti se arkëtimi i të hyrave të mbeturinave përmes komunës ka ndodhur në vitin e fundit dhe ka qenë një gabim teknik.

Opinionin jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Komuna e Vushtrisë është e ekspozuar edhe ndaj detyrimeve kontingjente dhe vlera e tyre siç është prezantuar në PVF e vitit 2018 pritet të jetë rreth 3,185,772€, e ku krahasuar me vitin 2017 këto detyrime ishin rritur për 34%. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të kreditorëve komuna pritet të ballafaqohet me vështirësi buxhetore në vitin e ardhshëm.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

¹ “Memorandumin e Mirëkuptimit mes Komunës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame për kryerjen e riteve fetare të varrimit si dhe shërbimeve dhe ceremonive përcjellëse” vlerë 33,390€;(MSH)

“Kujdesi shtëpiak për lehonat, personat e moshës së tretë dhe me atësi të kufizuara” vlerë 25,000€(MSH)

“Mbulimi i normave të interesit për bizneset dhe agrobizneset” vlerë prej 39,678€(IK)

² “Kontejnerë dhe rrethoja” në vlerë 58,550€

“Furnizimi me inventar për nevoja të shkollave, QKFM dhe QPS-le” vlerë 22,532€

“Furnizimi dhe montimi i pajisjeve në qendrën rinore në Vushtri” vlerë 2,160€

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Raportimin e obligimeve të papaguara;
- Raportet e progresit për projektet kapitale; dhe
- Pyetësin e vet-vlerësimit.

PFV-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura rekomandojmë:

Rekomandimi C1 Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime konkrete duhet të ndërmerren për të eliminuar gabimet në planifikimin/buxhetimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre. Gjithashtu, informatat lidhur me shpalosjen e të arkëtueshmeve duhet të jenë të plota me qëllim të prezantimit të tyre të plotë dhe të saktë në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Vushtrrisë kishte shpenzuar 90% të buxhetit final për vitin 2018 që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në arkëtimin e tyre dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe.

Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar: keq klasifikimin e shpenzimeve, angazhimin e një numri të lartë të punonjësve me marrëveshje të veçanta, pagesat me vendime gjyqësore dhe vonesat për përfundimin e projekteve kapitale.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	17,552,935	18,378,367	16,614,801	14,936,159	14,709,133
Granti i Qeverisë -Buxheti	15,204,413	14,951,916	14,760,460	13,244,927	13,124,948
Të hyrat vetjake ⁴	2,275,368	2,275,368	1,024,423	1,286,793	1,073,849
Të bartura nga viti paraprak ⁵	-	990,961	722,774	324,723	294,794
Donacionet e brendshme	-	69,919	57,774	53,767	45,192
Donacionet e jashtme	-	11,403	10,654	25,949	170,350
Huamarrjet	73,154	78,800	38,716	-	-

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

⁵ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 825,432€. Nga granti i Qeverisë buxheti kishte pasur reduktim prej 252,497€, ndërsa rritjet ishin rezultat i donacioneve të brendshme dhe të jashtme në vlerë prej 81,322€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 990,961€ si dhe me vendime të Qeverisë për huamarrjen për 5,646€.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final, ngjashëm me vitin 2017. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm edhe për kategori ekonomike dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	17,552,935	18,378,367	16,614,801	14,936,159	14,709,133
Pagat dhe Mëditjet	10,058,767	9,807,524	9,772,738	9,450,294	9,520,179
Mallrat dhe Shërbimet	2,551,008	2,606,921	2,006,102	1,397,121	1,444,943
Shërbimet Komunale	241,042	285,871	257,594	232,614	221,223
Subvencionet dhe Transferet	182,914	183,079	179,792	187,426	190,578
Investimet Kapitale	4,519,205	5,494,971	4,398,575	3,668,704	3,332,210

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 251,243€. Me vendim të qeverisë nr. 07/80 buxheti ishte reduktuar për 252,497€, përderisa një rritje kishte ndodhur nga të hyrat e bartura për 1,254€;
- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti ishte rritur për 55,913€. Rritja ka ndodhur nga të hyrat vetjake për 51,427€, grantet e donatorëve 1,098€ dhe nga huamarrjet 3,388€. Përderisa buxheti për shërbimet komunale ishte rritur për 40,000€ nga të hyrat vetjake dhe 4,829 të hyrat e bartura;
- Buxheti për subvencione ishte rritur për 165€ nga të hyrat e bartura; dhe
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 975,766€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura 893,284€, të hyrat nga grantet 80,224€ dhe nga huamarrjet për 2,258€.

Çështja C2⁶ - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Ligji Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Ne kemi identifikuar se gjatë këtij viti kishte pagesa nga kategoritë ekonomike jo adekuate si:

- Shpenzimet e ekzekutuara nga thesari në vlerë prej 97,617€ kishin të bënin me keq klasifikime pasi që nga Investimet kapitale ishin paguar paga të punonjësve të arsimit; dhe
- Shpenzimet për investime kapitale në vlerë prej 10,109€ që kishin të bënin me projektin kapital “Renovimi i objekteve të QMF-ve dhe instalimi i ngrohjeve qendrore” ishte paguar gabimisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Kjo ka ndodhur si shkak i mungesës së mjeteve financiare dhe mos planifikimit të mjeteve nga kategoria përkatëse.

Rreziku Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës, si dhe në mos realizimin e të gjitha projekteve kapitale të synuara për arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime bëhen konform ligjit të buxhetit dhe kodeve ekonomike të përcaktuara sipas planit kontabël për kategori.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2018 ishin në vlerë prej 1,658,673€. Prej tyre donacionet ishin me vlerë 71,208€.

Të hyrat e arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës ishin, nga gjobat në trafik 201,519€ dhe gjobat nga gjykatat 2,780€. Të hyrat kanë të bëjnë kryesisht me arkëtimet nga të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

⁶ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	2,275,368	2,275,368	1,658,673	2,021,801	1,428,884

Komuna kishte performancë të mirë në realizim të të hyrave prej 73%, megjithëse ka pasur rënie prej 18% në arkëtim krahasuar me vitin e kaluar, kjo për arsye se janë lëshuar më pak leje ndërtimi dhe rrjedhimisht janë arkëtuar më pak të hyra⁷.

Çështja A1 - Dobësitë në menaxhimin e të dhënave në tatimin në pronë

E gjetura Nga mostrat e testuara për pajtueshmërinë me rregulloret mbi vlerësimin e bazës tatimore kemi identifikuar dobësitë në vijim:

- Në dy nga dhjetë raste nuk ishin aplikuar normat adekuate të vlerësimit të bazës tatimore sipas koeficientëve të kualitetit bazuar në nenin 5 pika (1.8.1) të UA 03/2011⁸; dhe
- Në tri raste në mungesë të numrit personal në sistem (Protax) nuk kemi mundur ti identifikojmë përfituesit që kanë më shumë se një pronë dhe që kanë përfituar më shumë se një herë prej zbritjes lidhur me vendbanimin kryesor, bazuar në Ligjin nr 03/L-204. Si shkak i ndodhjes së këtyre dobësive kanë qenë ngarkesat në punë dhe neglizhenca.

Rreziku Mos aplikimi i normave të koeficientëve, numrit personal të tatim paguesve, mund të rezultojë me informata të paplota të pronës së tatueshme aktuale, pasi nuk përfshihen ndryshimet në vlerësimin e bazës tatimore si dhe rritë rrezikun për humbje potenciale financiare nga arkëtimi më i ulët.

Rekomandimi A1 Kryetari, duhet të sigurohet se vlerësimet e gjendjes në terren të pronave janë të reflektuara edhe në sistemin për kalkulimin e tatimit në pronë. Po ashtu, në sistem duhet plotësohen informatat që e mundësojnë identifikimin e përfitimit nga zbritja e vendbanimit kryesor. Krejt kjo me qëllim të rritjes së të hyrave nga tatimi në pronë.

⁷ Të hyrat nga lejet e ndërtimit (2018) 201,372€ përderisa (2017) 706,213€

⁸ Gjendja e pronës ndahet në 5 Kategori dhe Koeficientet e gjendjes së ndërtesës janë me sa vijon:

E shkëlqyeshme/shumë e mirë 1.1; E Mirë 1.0; Mesatare 0.8; E dobët 0.6; Shumë e dobët (e papërdorshme) 0.5

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për pagat dhe mëditjet ishte 9,807,524€ përderisa shpenzimet ishin 9,772,738€. Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe Ministria e Financave (MF).

Çështja B1 - Dobësi në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit

Gjetja Në procesin e rekrutimit për mësues klase, dhe mësimdhënës për edukatë fizike është kërkuar ndër tjera edhe vërtetimi i përvojës së punës dhe çertifikatat e trajnimeve. Gjatë testimit të lëndëve identifikua se të përzgjedhurit nuk i kishin plotësuar këto kritere.

Për më tepër edhe komisioni vlerësues nuk kishte mbajtur evidenca për vlerësimin/poentimin individual për kandidatët, por me një procesverbal ishte përmbledh i tërë procesi. Dobësitë e identifikuara janë shkaktuar nga neglizhenca, pakujdesia dhe kompetenca jo e duhur e komisioneve për ta kryer punën.

Rreziku Mos përmbushja e kritereve gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve rritë rrezikun që të jetë angazhuar personi jo meritor për pozitën e kërkuar.

Rekomandimi B1 Kryetari, duhet të sigurojë se respektohen dispozitat dhe kërkesat ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe të emërojë komisione profesionale me qëllim që gjatë procesit të vlerësimit të respektohen plotësisht kriteret e kërkuara në mënyrë që të sigurohet që vetëm kandidatët meritor kanë fituar pozitat e punës.

Çështja B2 – Mangësitë te marrëveshjet për shërbime të veçanta

Gjetja Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” (MSHV) për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Komuna gjatë vitit 2018 kishte të angazhuar 38 punonjës me MSHV. Për të gjitha rastet fillimisht janë përdorë procedura të thjeshtësuar të rekrutimit, përderisa për 23 prej tyre ju kishte vazhduar kontrata edhe për gjashtë muaj tjerë me kërkesë nga drejtoritë përkatëse ku ishin të angazhuar. Arsyeja pse janë lidhur këto kontrata ishte mungesa e mjeteve të planifikuara për këto pozita, dhe mundësia më e lehtë e angazhimit përkundër faktit se këto shërbime ishin kryesisht për pozita të rregullta⁹.

Rreziku Angazhimi i stafit me MSHV për pozita të rregullta, dhe vazhdimi i tyre edhe për gjashtë muaj pa procedura të thjeshtësuar kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që cilësia e shërbimeve të pranuar të mos jenë në përputhje me nevojat.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet të siguroj se angazhimi me MSHV bëhet vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.

⁹ Zyrtarë për Digjitalizim, Zyrtarë për Shërbim me qytetarë; Mirëmbajtës të Lumenjëve; Pyltarë etj

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për këtë kategori në vitin 2018 ishte 2,892,792€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,263,696€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet komunale, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera, etj.

Çështja A2 - Mangësitë në menaxhimin e kontratave

Gjetja Në aktvendimet për emërimin e menaxherit të kontratës theksohet se menaxheri duhet të konfirmoj përmes raportit të shkruar nëse furnizimet janë kryer në përputhje me kontratën. Ne identifikuam se në lëndë mungojnë raportet e menaxherëve të kontratës, si në rastet e më poshtme:

- Te dy pagesa në vlerë prej 10,879€ për kontratën “Furnizim me karburante dhe vaj për automjete, ngrohje dhe gjeneratorë” dhe te tri pagesa në vlerë prej 5,153€ për kontratën nga AQP “Furnizim me karburante për nevoja të A.K” mungonin raportet e menaxherëve të kontratës që e konfirmojnë pranimin; dhe
- Te pagesa në vlerë prej 240€ për kontratën e “Sigurimin e automjeteve” po ashtu mungonin këto raporte.

Mungesa e raporteve është shkaktuar ngase zyrtarët e caktuar si menaxher të kontratave nuk kanë qenë të informuar me udhëzimet për kërkesat e tilla.

Rreziku Mungesa e raporteve nga menaxherët e kontratave, rritë rrezikun e pagesave të pa rregullta dhe monitorimin e dobët në realizimin e kontratave.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj që me rastin e furnizimeve, pranimi i tyre të bëhet nga menaxherët përkatës përmes hartimit të raporteve në bazë të udhëzimeve përkatëse dhe se asnjë pagesë të mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen.

Çështja C3 - Vonesat në liferimin e mallrave

Gjetja Në kushtet e veçanta të kontratave definohet afati i liferimit të mallit. Kemi vërejtur se në tri kontrata (shtatë pagesa) kishte vonesa në liferim të mallrave dhe nuk janë aplikuar ndëshkime të përcaktuara në kontratë për këto raste:

- Në tri pagesa në vlerë prej 103,150€ për “Furnizim me lëndë djegëse – dru për ngrohje për nevoja të A.K - Vushtrri”, vonesat ishin nga 15 deri në 50 ditë përtej afatit të përcaktuar 10 ditor me kontratë;
- Në dy pagesa në vlerë prej 12,497€ për kontratën “Furnizim me material shpenzues dhe reagenca për laborator të QKMF-re” vonesat ishin nga 20 deri në 170 ditë mbi afatin e përcaktuar 5 ditor me kontratë; dhe
- Në dy pagesa në vlerë prej 2,197€ për kontratën “Furnizim me material për mirëmbajtjen e objekteve të A.K Vushtrri” vonesat ishin nga 19 dhe 37 ditë mbi afatin e përcaktuar 3 ditor me kontratë.

Arsyeja e vonesave ishte menaxhimi jo i duhur i kërkesave për furnizim nga Komuna dhe mos aplikimi i penaleve.

Rreziku Vonesat në liferimin e mallit sipas afateve të kontraktuara, paraqesin pengesë për zhvillimin e aktiviteteve operacionale të komunës.

Rekomandimi C3 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale, dhe në rastet e pajustificuara të vonesave në liferim të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 183,079€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 179,792€. Subvencionet ndahen për entitete publike dhe jopublike dhe kryesisht janë shpenzuar për të përkrahur sektorin e bujqësisë, kulturës, arsimit dhe shëndetësisë në kuadër të Komunës.

Çështja A3 – Dobësitë në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja

Kemi identifikuar disa dobësi në menaxhimin e subvencioneve të cilat kishin të bënin me mangësitë në përcaktimin e kriterëve për aplikim dhe monitorimin e tyre si:

- Te dhënia e subvencioneve për “makinë për konservimin e barit – rrotoballer” dhe “për përfitim të serave tipit tunel prej 2 ari”, kemi vërejtur së në të dy thirrjet për aplikim nuk ishin kërkuar kriterë të matshme dhe specifike për përzgjedhjen e përfituesve potencial. Kjo ka bërë që pothuajse të gjithë aplikantët të plotësojnë kriteret, andaj nga komisioni kanë ardhë në shprehje nën kriterë tjerë për selektim, që nuk ishin të shkruara. Për më tepër, për aplikantët e refuzuar me arsyen që kanë qenë përfitues në vitet e mëparshme, zyrtarët nuk kanë arritur të na dëshmojnë këtë vlerësim;
- Në dy pagesat në vlerë prej 13,000€ të përfituesve përmes Thirrjes Publike për financim të projekteve të personave juridik-OJQ, ne kemi vërejtur që përfituesit nuk kanë raportuar sipas nenit (4) të kontratës mbi bazën e raportimeve tre mujore dhe gjysmë vjetore të zbatimit të projektit. Raportimi ishte kryer pas përfundimit të projektit dhe atë jo për tërë shumën e përfutur; dhe
- Në një rast të subvencionimit për ndihmë personit fizik në vlerë prej 3,000€, përfituesi nuk ka raportuar në bazë të nenit 2.2.2 të marrëveshjes për mbikëqyrjen e shfrytëzimit të mjeteve, i cili parasheh raportimin e shpenzimeve të mjeteve nga ana e përfituesit pas 45 ditëve të përfitimit të subvencionit.

Arsyet e dobësive të shfaqura për menaxhimin e subvencioneve kanë të bëjnë kryesisht me mekanizmat e dobët të monitorimit nga ana e drejtorive përkatëse, dhe mos familjarizimi me kërkesat e rregullores së re të subvencioneve MF 04/2017.

Rreziku

Mos përcaktimi i kriterëve specifike dhe të matshme me rastin e përpilimit të thirrjeve për aplikim, e ka vështirësuar procesin e vlerësimit të aplikantëve dhe mund të ketë ndikuar në trajtimin jo të barabartë për aplikuesit. Po ashtu, mos respektimi i kushteve të kontratës mes komunës dhe përfituesve të subvencioneve, mund të rezultojë me keq menaxhim komfor qëllimit për të cilin është dhënë subvencionit.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të siguroj që kriteret në thirrjet publike për aplikim të jenë të matshme, specifike dhe të qarta, duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës. Po ashtu, duhet të rriten kontrollet monitoruese pas shpërndarjes së subvencioneve.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,494,971€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 4,398,575€. Investimet kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, ndërtim të shkollave, shpronësime, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja B3 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten.

Ne kemi identifikuar pesë¹⁰ projekte për punë për të cilat komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por kishte zhvilluar procedurat e prokurimit vetëm me paramasën dhe parallogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte tek ndërtimi i rrugëve. Kjo kishte ndodhur për shkak të skadimit të kontratës që komuna kishte për hartimin e projekteve dhe vonesave në procedurat e prokurimit për lidhjen e kontratës së re.

Rreziku Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin e profesional ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të forcoj kontrollet për të siguruar se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UOPP për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë. Proceset e prokurimit për projekte ekzekutive duhet të kryhen në fillim në mënyrë që t'i paraprijnë inicimit të prokurimit të projekteve tjera për punë.

¹⁰ "Asfaltimi i 14 rrugëve në komunën e Vushtrrisë - llot 1";
"Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Reznik";
"Asfaltimi i rrugëve lokale në katër fshatrat e komunës së Vushtrrisë, llot 3";
"Asfaltimi i rrugëve lokale Vushtrri-Sllatinë" dhe
"Asfaltimi i nëntë rrugëve lokale të Komunës së Vushtrrisë".

Çështja B4 - Vonesat në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja

Në kushtet e veçanta të kontratave të punës ishte definuar afati për realizimin e punimeve. Në projektet e mëposhtme identifikua vonesa në realizimin e projekteve si:

- Kontrata “Asfaltimi i rrugës lokale Vushtrri Sllatinë” në vlerë prej 173,319€ e datës 24.09.2018, ishte paraparë të përfundoj me datë 25.11.2018 (vonesa - 60 ditë kalendarike);
- Kontrata “Asfaltimi i nëntë rrugëve lokale të Komunës së Vushtrrisë” në vlerë prej 128,234€, e datës 31.10.2018, ishte paraparë të përfundoj me datë 03.01.2019 (vonesa - 40 ditë pune); dhe
- “Asfaltimi i rrugëve në 14 fshatrat e Komunës së Vushtrrisë - llot1 “Asfaltimi i rrugëve në shtatë fshatra” në vlerë 133,535€ e datës 31.07.2018, ishte paraparë të përfundoj me datë 11.12.2018 (vonesa - 90 ditë pune).

Në të gjitha projektet e lartë përmendura punët nuk kishin përfunduar deri në kohën sa ne ishim në auditim 29.03.2019.

Gjithashtu kemi rishikuar realizimin e projekteve të cilat ishin trajtuar si vonesa në raportin e auditimit të vitit 2017. Te projekti “Renovimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinolli” kemi vërejtur se punët ende nuk kishin përfunduar, përkundër që ky projekt ishte paraparë të përfundonte me 04.12.2017.

Vonesat në realizimin e kontratave kryesisht ishin për shkak të mungesës së menaxhimit adekuat nga ana e komunës, mungesës së projekteve ekzekutuese, problemeve me banorët lokal për shkak të çështjeve të pa definuara pronësore, kushteve atmosferike, specifikave të punëve etj.

Rreziku

Mungesa e projekteve ekzekutuese si dhe mos identifikimi i pengesave me kohë, ka ndikuar në vonesat në realizimin e projekteve kapitale. Këto vonesa ndikojnë në mos arrijten e objektivave në realizimin e projekteve kapitale.

Rekomandimi B4

Kryetari, duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet e rasteve të vonesave dhe të sigurojë që planet dinamike të përputhen me afatet reale të përfundimit të punëve, si dhe të sigurojë se për çdo projekt ekziston projekti ekzekutues. Po ashtu, duhet të analizohen dhe shqyrtohen shkaqet që kanë ndikuar në ngeçjet e projekteve si pasojë e dobësive në proceset e prokurimit dhe të marrë masa për përmirësimin e menaxhimit të tyre.

Çështja A4 - Ndryshimi i kushteve të kontratës gjatë përmbushjes së saj

Gjetja Sipas kushteve të kontratës për “Mbulimin e normave të interesit për kredi marrësit” në nenin (3.3) ishte përcaktuar që pagesa e normës së interesit do të bëhej në baza mujore për periudhën 36 mujore.

Kemi vërejtur se në fillim të implementimit të kësaj kontrate është bërë revidimi i saj me ç’rast ka ndryshuar ky nen, duke mundësuar pagesën totale të interesit me rastin e marrjes së kredisë. Shkaku i revidimit/ndryshimit të kontratës sipas zyrtarëve, ka qenë kërkesa e bankës e cila ishte aprovuar nga menaxheri i kontratës dhe zyra e prokurimit.

Rreziku Nëse kriteret e përcaktuara në revidimin e kontratës do të ishin vendosur në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, do të ishte mundësia më e madhe e pranimit të ofertave më konkurruese me norma më të ulëta si dhe përfitimi i komunës mund të ishte më i lartë.

Rekomandimi A4 Kryetari, duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit paraprakisht një analizë dhe vlerësim objektiv të kriterëve që duhet të vendosen në dosje të tenderit, me qëllim të krijimit të konkurrencës së operatorëve duke marrë ofertën më përfituese për Komunën. Ndryshimet e tilla të kushteve të kontratës nuk duhet të lejohen.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja A5 - Pagesat e ekzekutuara nga Thesari për vendimet Gjyqësore

Gjetja Neni 39 i LMFPP përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Ne kemi identifikuar se Thesari kishte ekzekutuar në bazë të vendimeve gjyqësore pagesa në vlerë prej 97,617€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 79,838€ dhe shpenzimet procedurale të gjykatës (përmbartimit) ishin 17,779€. Po ashtu, kjo formë e pagesave nga thesari ka ndikuar në keq klasifikimin e shpenzimeve, marrjen e mjeteve nga kategoritë ekonomike jo adekuate.

Pagesat kryesisht kishin të bëjnë me pagesat e dala nga marrëveshja kolektive për pagesë të tri pagave jubilarë të punonjësve të arsimit dhe tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit si shkak i mungesës së mjeteve buxhetore.

Rreziku Situata e krijuar që pagesat të ekzekutohen direkt nga ana e Thesarit përmes procedurave të përmbartimit ndikon direkt në rritjen e kostos për Komunën dhe njëherit edhe në keq klasifikimin e shpenzimeve

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPP, për të shmangur pagesat me vendime përmbartimore dhe me kosto më të lartë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të 2018 ishte 109,185,932€ ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 308,730€. Stoqet në fund vit ishin 48,922€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim.

Çështja A6 - Dobësitë në menaxhimin e pasurive

Sipas nenit (6.1) rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, përcakton që çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Ne kemi vërejtur se në tri raste pasuritë e blera nuk ishin regjistruar në sistemin e SIMFK-së si:

- Pagesa për “Furnizimi me automjet terreni për nevojat e QKMF-re” me vlerë 27,950€, e datës 20.11.2018;
- Pagesa për “Renovimi i objekteve të QMF-ve dhe instalimi i ngrohjes qendrore” me vlerë 10,109€, e datës 24.12.2018; dhe
- Pagesa për “Renovimi i shkollave fillore dhe të mesme në komunën e Vushtrisë” me vlerë 3,311€, e datës 11.09.2018.

Gjithashtu, mangësi janë vërejtur edhe në menaxhimin e sistemit E-pasuria pasi për disa pasuri nuk është kalkuluar fare zhvlerësimi.

Komuna kishte bërë përpjekje dhe kishte arritur të ketë një menaxhim më të mirë të pasurisë, megjithatë rastet e identifikuara më lartë vijnë si pasojë e neglizhencës së zyrtarëve, si dhe menaxhimit jo adekuat të sistemit E-Pasuria nga ana e Ministrisë së Administratës Publike.

Rreziku

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë, si dhe mos llogaritja e zhvlerësimit të E-Pasurisë, ndikon që pasuria e Komunës të jetë e nënvlerësuar dhe shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që e posedon komuna duke rezultuar në prezantimin jo të drejtë të tyre në PFV.

Rekomandimi A6 Kryetari, duhet të sigurohet që regjistri i pasurive azhurnohet me të gjitha informatat relevante në mënyrë që të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive duke mos e nënvlerësuar e as mbivlerësuar pasurinë në PFV. Në këtë aspekt duhet të sigurojë kontrolle në evidentimin e plotë të pasurisë kapitale dhe jo kapitale.

3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në PFV në fund të vitit ishin 3,257,284€. Strukturën e të arkëtueshmeve e përbëjnë: tatimi në pronë, taksa në biznes, qiratë dhe lejet e ndërtimit. Pjesëmarrjen më të madhe në këtë strukturë e kanë tatimi në pronë në vlerë 2,711,767€, dhe taksa në biznes në vlerë 476,472€.

Çështja B5 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Nga viti paraprak ato janë rritur për 267,692€, apo rreth 10%, e ku rritja më e madhe është te tatimi në pronë (rritja nga viti paraprak 264,306€). Komuna për borxhet në tatimin në pronë kishte dërguar vërejtje për pagesë megjithatë nuk kishte marrë ndonjë veprim konkret që të arkëtueshmet t'i arkëtoj përmes përmbaruesve si një mundësi për mbledhjen e të arkëtueshmeve.

Te shpalesjet e të arkëtueshmeve, përveç mos përfshirjes së saldove për shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave në vlerë prej 309,175€¹¹, saldot fillestare janë nënvlerësuar për 5,269€ (taksat në biznes 4,396€ dhe shfrytëzimi i pronës publike 873€). Viti i parë i menaxhimit të të hyrave nga mbeturinat (nga ana e komunës) ishte shkaku i mos prezantimit të plotë të të arkëtueshmeve, përderisa problemet e identifikuar te saldot ka të bëjë me neglizhencën dhe kompetencën e zyrtarëve që menaxhojnë me këto të dhëna.

Rreziku Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme rezulton me rritje të këtyre llogarive, rrezikon që komuna të ketë humbje financiare si dhe rrezikon mos realizimin e projekteve të komunës. Mos raportimi i plote i llogarive të arkëtueshme ka për rrezik saktësinë dhe plotësinë e informatave për të arkëtueshmet dhe shpalesjen e tyre në PFV.

Rekomandimi B5 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duhet të sigurojë procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre. Posedimi i një plani dhe programi operativ dhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve do ta rrisin nivelin e mbledhjes së borxheve.

¹¹ Theksimi i çështjes

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 90,477€ përafërsisht 25% më të ulëta se vitin paraprak (obligimet e vitit 2017 ishin 121,141€), një indikacion i mirë që komuna i ka dhënë përparësi shlyerjes së obligimeve ndaj furnitorëve.

Çështja B6 - Vonesat në pagesa si dhe dobësitë në raportimin e obligimeve

Gjetja Sipas Rregullës financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të OB-ve, neni 5 pika 3 thekson se “Raporti mujor i obligimeve të papaguara”, duhet të përfshijë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur”. Po ashtu, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagesë, ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Ne kemi vërejtur se:

- Në 7 mostra në vlerë prej 53,788€ kemi identifikuar se ka vonesa në pagesat e faturave nga ana e komunës prej 25 deri në 120 ditë; dhe
- Nga 11 mostrat e testuara, në 3 prej tyre me vlerë 520€ kemi identifikuar që Komuna me rastin e paraqitjes së obligimeve të papaguara në MF nuk kishte përfshi në raporte edhe obligimet e muajit përkatës.

Shkaku i mos raportimeve të plota në thesar ka ardhë si pasojë e pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës, ndërsa vonesat në pagesa ishin kryesisht si shkak i mungesës së buxhetit.

Rreziku Kontrollat e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve mujore, paraqesin pasqyrim jo të drejtë të obligimeve, ndërsa vonesat në pagesa krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues si dhe mundësinë e ekzekutimeve direkt nga Thesari.

Rekomandimi B6 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet sipas rregullës financiare 02/2013.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Procesi për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të vitit paraprak, mungesa e proceseve monitoruese për menaxhimin e rrezikut dhe kontrole të dobëta mbi shpenzimet dhe të hyrat janë disa nga dobësitë e identifikuara në qeverisje. Komuna me kohë kishte përmbushë kërkesën për dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit në MF. Njëra nga çështjet e pyetësorit e cila kishte të bënte me proceset efektive të monitorimit lidhur me progresin e objektivave, konsiderohet si e vendosur nga ana e komunës mirëpo, nuk na janë ofruar dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve.

Komuna posedon këto plane: Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024, Planin Zhvillimor të Arsimit 2017-2020, përderisa nuk posedon Plane Rregulluese Urbane dhe është në hartim e sipër të Hartës Zonale.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - drejtori dhe një auditor. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë gjashtë auditime, të cilat edhe ishin realizuar.

Komiteti i auditimit ishte formuar me datë 26.02.2018, ishte funksional dhe kishte mbajtur pesë takime të rregullta ku janë shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm duke i dhënë mbështetje NjAB-së me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ana e menaxhmentit.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalesje e rezultateve në mënyrë transparente.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja C4 - Dobësi në kontrollet menaxheriale

Gjetja Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Pavarësisht se linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta javore, formati aktual i raportimeve menaxheriale nuk ofron bazë për kontrolle të brendshme efektive meqenëse raportimi me shkrim tek menaxhmenti i lartë bëhet vetëm sipas kërkesës dhe jo në baza të rregullta kohore.

Rreziku Kërkesat jo të qarta të llogaridhënies dhe raportimit financiar duhet të forcohen për të përkrahur efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, në mënyrë që informacioni financiar të jetë i plotë në funksion që ta përkrahë vendimmarrjen e menaxhmentit.

Rekomandimi C4 Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është përcaktuar forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të komunës ka rezultuar me 21 rekomandime kryesore. Komuna e Vushtrisë kishte përgatitur Planin e Veprimit ku kishte paraqitur mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i ZKA-së, bashkë me planin për implementimin e rekomandimeve ishte diskutuar në Asamblenë Komunale në mbledhjen e datës 26.07.2018.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, dhjetë (10) rekomandime janë zbatuar; gjashtë (6) rekomandime ishin të përsëritura; katër (4) pjesërisht të përsëritura si dhe një rekomandim ishte i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në planifikimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre në PFV.</p> <p>Po ashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	Komuna kishte arritur të regjistrojë pasurinë saj në sistemin e E-Pasurisë, përderisa pjesa e keq klasifikimeve të buxhetuara mbetet çështje e përsëritur.	Rekomandim pjesërisht i përsëritur Ref: C1
2	Menaxhimi financiar dhe Kontrolli	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit me kohë dhe në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Me tutje, duhet të sigurojë se planifikimi dhe buxhetimi i shpenzimeve bëhet konform natyrës së tyre, bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.	Komuna kishte arritur të ketë realizim prej 80% të buxhetit për kategorinë investime kapitale, pjesa e keq klasifikimeve mbetet çështje e përsëritur.	Rekomandim pjesërisht i përsëritur Ref: C2
3	Të hyrat	Kryetari, duhet t'i analizojë pengesat në zbatimin e kësaj kërkesë dhe të identifikojë mënyra për adresimin e rekomandimit në këtë fushë. Në këtë aspekt, duhet të siguroj mekanizma efektiv për verifikimin e kuotës së përcaktuar prej 1/3-ës së pronave për tatimin në pronë, siç kërkohet me udhëzimin administrativ.	Komuna kishte arritur të verifikojë pronat-kuotën prej 20% me ligjin e ri.	Rekomandim i zbatuar

4	Të hyrat	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle efikase në departamentin e tatimit në pronë, konkretisht në menaxhimin e të dhënave në sistemin Protax. Gjithashtu edhe verifikimi i pronave në teren do të mundësonte që të dhënat të azhurnohen në bazë të gjendjes faktike në teren.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
5	Të hyrat	Kryetari, në bashkëpunim me drejtorinë e urbanizimit duhet që të sigurojë aplikimin e kontrolleve shtesë për të siguruar se është duke u aplikuar në tërësi rregullorja për tarifa 2015. Në këtë aspekt do eliminohet mundësia e aplikimit të standardeve të dyfishta për çështjet e njëjta.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
6	Menaxhimi i personelit	Kryetari, duhet të sigurojë se respektohen dispozitat dhe kërkesat ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit, dhe të sigurohet që vetëm kandidatët meritor kanë fituar pozitat e punës.	Nuk janë marrë veprime.	Rekomandim i përsëritur Ref: B1
7	Menaxhimi i personelit	Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.	Nuk janë marrë veprime.	Rekomandim i përsëritur Ref: B2
8	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërprerë praktikatat e vazhdimit të kontratave në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit si dhe të sigurojë se janë analizuar mjaftueshëm shkaqet e rasteve të identifikuara. Njësitë kërkuese duhet të paraqesin me kohë kërkesat dhe specifikimet e sakta për llojin dhe nevojën e shërbimeve. Me tutje procedurat e tenderimit të fillojnë më kohë për të shmangur vonesat në lidhjen e kontratave.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
9	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale, nga komisionet përkatëse. Në rastet e vonesave në liferimin e mallrave dhe shërbimeve të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.	Komuna kishte arritur të evitonte parregullsitë në pranimin e mallrave, kurse liferimi i	Rekomandim pjesërisht i përsëritur Ref: C3

			mallrave mbetet çështje e përsëritur.	
10	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të forcoj kontrollet për të siguruar se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UA i KRPP nr. 1/2014 për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë.	Nuk janë marrë veprime.	Rekomandimi i përsëritur Ref: B3
11	Investimet Kapitale	Komuna, duhet të siguroj realizimin e projekteve sipas prioriteteve, duhet të siguroj se evitohen pengesat në realizimin e projektit dhe se do të bëjë të gjitha përpjekjet që projektet të realizohen sipas marrëveshjes.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandimi i zbatuar
12	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet e rasteve të identifikuar dhe të sigurojë që planet dinamike të përputhen me afatet reale të përfundimit të punëve, si dhe të sigurojë se për secilin kontratë janë të hartuara projektet ekzekutive. Po ashtu, duhet të analizohen dhe shqyrtohen shkaqet që kanë ndikuar në ngeçjet e projekteve si pasojë e dobësive në proceset e prokurimit dhe të marrë masa për përmirësimin e menaxhimit të tyre.	Nuk janë marrë veprime.	Rekomandimi i përsëritur Ref: B4
13	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të siguroj se planet e menaxhimit të kontratave azhurnohen me kohë në bazë të kryerjes së punëve. Po ashtu në rast të mungesës së stafit të mjaftueshëm, të shqyrtohet edhe mundësia e angazhimit të stafit jashtë njësive kërkuese për menaxhimin e kontratave.	Këtë vit menaxhimi i kontratave është bërë nga më shumë persona.	Rekomandimi i zbatuar
14	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të siguroj se menaxhimi i procesit të shpenzimeve përkatësisht autorizimit të pagesave të bëhen në bazë të kërkesave ligjore, në mënyrë që të parandalohen mundësitë për keq përdorime.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandimi i zbatuar
15	Çështjet e përbashkëta	Kryetari, duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se para përgatitjes së projekteve bëhen analiza të mjaftueshme lidhur me nevojat për furnizimet/punët e kontraktuara. Në këtë mënyrë do të përmirësohet menaxhimi i kontratave dhe	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandimi i zbatuar

		do të shmangen rastet e tejkalimit mbi normën e lejuar +/-30%.		
16	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbushur kërkesat ligjore për formimin e komisioneve të cilat do të përfundojnë raportet sipas kërkesave të parapara në rregullore me qëllim që të reflektojnë puna e komisioneve në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore. Gjithashtu kryetari duhet të siguroj se e tërë pasuria e komunës identifikohet me barkode.	Për vitin 2018 ishin formuar komisionet dhe pasuria kishte të vendosura barkodet.	Rekomandim i zbatuar
17	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duhet të sigurojë procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre. Posedimi i programit efektiv do ta lehtësonte punën dhe mirëmbajtjen e këtyre llogarive.	Nuk janë marrë veprime.	Rekomandim i përsëritur Ref: B5
18	Obligimet e Papaguara	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet sipas rregullës financiare 02/2013.	Nuk janë marrë veprime.	Rekomandim i përsëritur Ref: B6
19	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari, duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka nevojë, të propozohen masat adekuate.		Rekomandim i mbyllur
20	Auditimi i Brendshëm	Kryetari në bashkëpunim me kryesuesin e KA-së duhet të analizojnë situatën aktuale dhe të sigurojë funksionimin normal të aktiviteteve të komitetit komfor kërkesave ligjore me qëllim të arritjes së objektivave të themelimit të KA-së.	Në vitin 2018 është funksionalizuar Komiteti i Auditimit.	Rekomandim i zbatuar
21	Raportimi menaxherial logaridhënia dhe	Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin	Lista e rreziqeve për vitin 2018 ishte vendosur nga	Rekomandim pjesërisht i përsëritur

	menaxhim i i rrezikut	efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.	ana e Komunës.	Ref: C4
N r	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV Ref: C1	Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime konkrete duhet të ndërmerren për të eliminuar gabimet në planifikimin/buxhetimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre. Gjithashtu, informatat lidhur me shpalosjen e të arkëtueshmeve duhet të jenë të plota me qëllim të prezantimit të tyre të plotë dhe të saktë në PFV.		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit Ref: C2	Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime bëhen konform ligjit të buxhetit dhe kodeve ekonomike të përcaktuara sipas planit kontabël për kategori.		
3	Të Hyrat - Ref: A1	Kryetari, duhet të sigurohet se vlerësimet e gjendjes në terren të pronave janë të reflektuara edhe në sistemin për kalkulimin e tatimit në pronë. Po ashtu, në sistem duhet plotësohen informatat që e mundësojnë identifikimin e përfitimit nga zbritja e vendbanimit kryesor. Krejt kjo me qëllim të rritjes së të hyrave nga tatimi në pronë.		
4	Paga dhe Meditje - Ref: B1	Kryetari, duhet të emërojë komisione profesionale dhe të siguroj se komisionet gjatë procesit të vlerësimit i respektojnë plotësisht kriteret e kërkuara në mënyrë që të sigurohet që vetëm kandidatët meritator kanë fituar pozitat e punës.		
5	Paga dhe Meditje - Ref: B2	Kryetari, duhet të siguroj se angazhimi me MSHV bëhet vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e meditjeve.		
6	Mallra dhe Shërbime - Ref: A2	Kryetari duhet të siguroj që me rastin e furnizimeve, pranimi i tyre të bëhet nga menaxherët përkatës përmes hartimit të raporteve në bazë të udhëzimeve përkatëse dhe se asnjë pagesë të mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen.		
7	Mallra dhe	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtese të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale, dhe në rastet e		

	Shërbime - ref. C3	vonesave në liferimin e mallrave dhe shërbimeve të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.
8	Subv&Tra nsf. - Ref: A3	Kryetari duhet të siguroj që kriteret në thirrjet publike për aplikim të jenë të matshme, specifike dhe të qarta, duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës. Po ashtu, duhet të rriten kontrollet monitoruese pas shpërndarjes së subvencioneve.
9	Inv. Kapitale - Ref: B3	Kryetari, duhet të forcoj kontrollet për të siguruar se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UOPP për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë. Proceset e prokurimit për projekte ekzekutive duhet të kryhen në fillim në mënyrë që t'i paraprijnë inicimit të prokurimit të projekteve tjera për punë.
10	Inv. Kapitale - Ref: B4	Kryetari, duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet e rasteve të vonesave dhe të sigurojë që planet dinamike të përputhen me afatet reale të përfundimit të punëve, si dhe të sigurojë se për çdo projekt ekziston projekti ekzekutues. Po ashtu, duhet të analizohen dhe shqyrtohen shkaqet që kanë ndikuar në ngecjet e projekteve si pasojë e dobësive në proceset e prokurimit dhe të marrë masa për përmirësimin e menaxhimit të tyre.
11	Inv. Kapitale - Ref: A4	Kryetari, duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit paraprakisht një analizë dhe vlerësim objektiv të kriterëve që duhet të vendosen në dosje të tenderit, me qëllim të krijimit të konkurrencës së operatorëve duke marrë ofertën më përfituese për Komunën. Ndryshimet e tilla të kushteve të kontratës nuk duhet të lejohen.
12	Çështjet e përbashkë ta - Ref: A5	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPP.
13	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale Ref: A6	Kryetari, duhet të sigurohet që regjistri i pasurive azhurnohet me të gjitha informatat relevante në mënyrë që të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive duke mos e nënvlerësuar e as mbivlerësuar pasurinë në PFV. Në këtë aspekt duhet të sigurojë kontrolle në evidentimin e plotë të pasurisë kapitale dhe jo kapitale.
14	Të arkëtuesh met Ref: B5	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duhet të sigurojë procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimin të tyre. Posedimi i një plani dhe programi operativ dhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve do ta rrisin nivelin e mbledhjes së borxheve.

15	Obligimet Ref: B6	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet sipas rregullës financiare 02/2013.
16	Raportimi menaxherial Ref: C4	Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është përcaktuar forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br. 686/19

Nr. i fq. / Br. st. _____

Data / Datum. 27.05.2019

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE: PRANUAR DORËZUAR: _____
DATE: PRILJEN DOSTAVLJEN: 27.05.2019
DATE RECEIVED/SUBMITTED: _____

Njësia Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
04	47	835	1

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Vushtrrisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Xhafer Tahiri 

Kryetar i Komunës së Vushtrrisë,

Data: 27. Maj.2019, Vushtrri,